

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

RRETH NESH

NJOFTIME

SEANCA PLENARE

LEGJISLACION

PROGRAMI I TRANSPARENCËS

SEANCË DËGJIMORE

NJOFTIM PËR MEDIA MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES PLENARE DATË 25.04.2024

BY KLP 25/04/2024 AKTIVITETE, PËR MEDIAT

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, u mbledh sot, në datë 25.04.2024, në seancë plenare, në prani të 10 (dhjetë) anëtarëve dhe në prani të përfaqësuesve nga Ministria e Drejtësisë dhe Misioni OPDAT.

Gjatë kësaj seance u miratuan aktet si më poshtë:

1. Shpallja e vendimit për procedimin disiplinor ndaj magjstrates Shqiponja Milla ku u vendos rrëzimi i kërkesës së ILD-së për masë disiplinore "Vërejtje konfidenciale"
2. Miratimi i procesverbaleve të Seancave Plenare të datave 28.03.2024, 29.03.2024 dhe 12.04.2024;
3. Caktimin e përkohshëm të prokurores Elidjana Kasa në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
4. Ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.137, datë 07.06.2023, "Për verifikimin e kandidatëve, për plotësimin e kushteve ligjore të kandidimit, për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, të shpallura me Vendimin Nr.92, datë 09.05.2023 të KLP-së", dhe caktimit me short të zotit Sokol Stojani, si relator në këtë procedurë;
5. Një ndryshim në Vendimin Nr.289, datë 17.07.2023, të Këshillit "Për praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës dhe zëvendësimin e zotit Milan Laskaj me prokuroren Esmeralda Keshi;
6. Verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurores Anita Jella, në kuadër të kandidimit për riemërim për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

[RRETH NESH](#)[NJOFTIME](#)[SEANCA PLENARE](#)[LEGJISLACION](#)[PROGRAMI I TRANSPARENCËS](#)[SEANCË DËGJIMORE](#)

8. Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2024, Znj. Brisida Leka;
9. Hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027” të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
10. Raportit Vjetor të Veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për Vitin 2023.
Gjithashtu, në këtë Seancë Plenare u diskutuan çështjet:

- Mbi vendimin e KPA-së për zonjën Antoneta Sevdari nisur nga kërkesa e vetë subjektit;
- Mbi kërkesën e prokurores Pranvera Gruda për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ;
- Mbi daljen e Këshillit me një akt rekomandues pas raportimit të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme (SPAK) dhe Prokurorit të Përgjithshëm si dhe,
- Mbi tezat e diskutimit në mbledhjen e përbashkët midis KLP-së dhe KLGj-së.

< NJOFTIM MBI REZULTATET E
VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR
LËVIZJE PARALELE NË
KATEGORINË E NIVELIT
EKZEKUTIV

SEANCA PLENARE NR.205 >

KËRKO

NJOFTIME